



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më, \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **SHOQËRINE OE "O.E.S DISTRIMED" Shpk, me NIPT K31520054N,**  
*Adrese: Tirane, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastrati"*

**Procedura e prokurimit: Kërkese Propozim**

**Numri i referencës së procedurës : REF-91792-03-30-2021**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje kite për matjen e glicemisë së shpejtë" me Fond Limit: 821.400 (teteqind e njetzet e nje mije e katerqind) Lek pa TVSH Lek pa TVSH dhe 985.680 (nenteqind e tetedhjetete e pese mije e gjashteqind e tetedhjetete ) Lek me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit**

**Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.**

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- **Operatori Ekonomik "SALTON" Shpk, me NIPT K62212030P i cili ka ofertuar me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 749 496 (shtateqind e dyzet e nente mije e katerqind e nentedhjetete e gjashte) leke pa TVSH dhe 899 395 (teteqind e nentedhjetete e nente mije e treqind e nentedhjetete e pese) Leke me TVSH.**
- **Operatori Ekonomik "ALBAPHOTO" Shpk, me NIPT K86618008S i cili ka ofertuar me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 814 000 (teteqind e katermbedhjetete mije) leke pa TVSH dhe 976 800 (nenteqind e shtatedhjetete e gjashte mije e teteqind) leke me TVSH.**
- **Operatori Ekonomik "O.E.S DISTRIMED" Shpk, me NIPT K31520054N i cili ka ofertuar me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 814 000 (teteqind e katermbedhjetete mije) leke pa TVSH dhe 976 800 (nenteqind e shtatedhjetete e gjashte mije e teteqind) leke me TVSH.**

Jane skualifikuar OE të mëposhtëm:

- Operatori Ekonomik “SALTON” Shpk, me NIPT K62212030P.
- Operatori Ekonomik “ALBAPHOTO” Shpk, me NIPT K86618008S.

Perkatësisht për arsye të mëposhtme:

**Operatorit Ekonomik “SALTON” Shpk, me NIPT K62212030P, me adrese: TIRANE Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Qemal Stafa, Godina nr 2, përfaqësuar nga Administratori znj.Irida BASHA,**

Nga shqyrtimi I dokumentacionit u konstatua se:

Ne DST per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim pika **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar** eshte kerkuar:

*a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve (2017, 2018, 2019) të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.*

**OE “SALTON” nuk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi bilancin e vitit 2017 te kerkuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit.**

Gjithashtu Ne DST per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim pika **2.3. Për kapacitetin teknik** eshte kerkuar:

*2. Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese), për plotësimin e afatit të skadencës së tyre, si dhe respektimit të specifikimeve teknike të kërkuara nga shërbimi mjekësor.*

OE “SALTON” ka paraqitur nje deklarate vetem per skadencën e mallit dhe deklaraten per per respektimin e specifikimeve teknike ne permbushje te pikes ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;* por nuk ka dorezuar deklaraten mbi origjinën e mallit ne permbushje te pikes 2.

Ne DST per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim pika **2.3. Për kapacitetin teknik** eshte kerkuar:

*8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotësohet: Specifikimet teknike, **Emri i kompanisë prodhuese**, Origjina e mallit, Skadencia e mallit. Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti. Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.*

OE “SALTON” deklaron ne ofertën teknike se prodhuesi eshte TRIMPEKS/TAIWAN, referuar dokumentave te paraqitura per kete procedure rezulton se prodhuesi eshte TYSON BIORESEARCH Inc/TAIWAN.

Per sa me siper argumentuam, OE SALTON nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST nga AK, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, **duke e konsideruar oferte te pavlefshme.**

**Operatorit Ekonomik “ALBAPHOTO” Shpk, me NIPT K86618008S, me adrese: Lagjia Pedonale, Rruga Kole Idromeno, Godina Nr.4, Kati 2 Shkoder, përfaqësuar nga Administratori z.Alban Xhaferri,**

Nga shqyrtimi I dokumentacionit u konstatua se:

Ne DST per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim pika **dh)** eshte kerkuar:

*dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë).*

Nga dokumentacioni i paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik per kete procedure prokurimi rezulton qe OE “ALBAPHOTO” ka parqitur nje vertetim OSHEE i cili nuk eshte koherent pasi ne kohen e zhvillimit te tenderit OE duhet te kishte dorezuar nje vertetim OSHEE i cili perfshin dhe pagesen per muajin Shkurt 2021, per kete arsye vertetimi I dorezuar nuk eshte I vlefshem.

Ne DST per kete procedure prokurimi ne kriteret e vecanta per kualifikim pika **2.3. Për kapacitetin teknik** eshte kerkuar:

*7. Te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, **nese nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe te noterizohen**). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.*

Nga dokumentacioni i paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik per kete procedure prokurimi rezulton qe OE “ALBAPHOTO” ka parqitur katalogun original ne gjuhen angleze te paperkthyer ne gjuhen shqipe.

Per sa me siper argumentuam, OE ALBAPHOTO nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST nga AK, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, **duke e konsideruar oferte te pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Operator Ekonomik i suksesshëm “**O.E.S DISTRIMED**” Shpk me NIPT **K31520054N**, i cili ka ofertuar me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **814 000** (teteqind e katermbedhejte mije) **leke pa TVSH** dhe **976 800** (nenteqind e shtatedhjte e gjashte mije e teteqind) **leke me TVSH.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.04.2021.**

**Ankesa:** Nuk ka patur ankesa.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Enkelejdi JOTI**